



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.267/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-86005-02-04-2021, me objekt “*Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, QKB, Agjencinë e Pyjeve, SHMZSH dhe Gjendjen Civile*” - *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 8,421,400 (tetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e katërqind) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

**Ankimues:** “Infosoft Office” SHPK  
Autostrada Tiranë-Durrës, km8, Kashar, Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Elbasan  
Rr. “Qemal Stafa”, Elbasan

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar shkallët e ankimimit dhe afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-86005-02-04-2021, me objekt: “*Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, QKB, Agjencinë e Pyjeve, SHMZSH dhe Gjendjen Civile*” - *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 8,421,400 (tetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e katërqind) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

II.2. Në datën 19.04.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 07.05.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Infosoft Office	296,867.97	I skualifikuar
- Artan Llozana	327,126.21	I kualifikuar
- Ervin Luzi	403,965.00	I skualifikuar
- Interlogistic	635,846.82	I kualifikuar

II.4. Në datën 07.05.2021 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 28.05.2021, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë: “Kompania “InfoSoft Office” ShPK mori pjesë në tenderin me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, QKB, Agjencinë e Pyjeve, SHMZSH dhe Gjendjen Civile” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, që Bashkia Elbasan zhvilloi me datë 19.04.2021. Me datë 07.05.2021 morëm klasifikimin përmes faqes së APP-së:

- Infosoft Office	296,867.97	I skualifikuar
- Artan Llozana	327,126.21	I kualifikuar
- Ervin Luzi	403,965.00	I skualifikuar
- Interlogistic	635,846.82	I kualifikuar

Kur shohim që oferta jonë është renditur e para me vlerën më të ulët, por është skualifikuar me arsyetimin: Operatori ekonomik në përmbushje të pikës 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë dorazi kampione të të gjithë artikujve sipas listës së tonerave si dhe mostër të letrës format A4 dhe A3 (një rismë për secilën), pranë Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Prokurimeve Publike në datën dhe në orën e zhvillimit të tenderit. Këto mostra do të verifikohen nga enti prokurues dhe do të mbahet një procesverbal për përmbushjen ose jo të specifikimeve teknike. Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht për skualifikim. Sipas procesverbalit të mbajtur nga komisioni i vlerësimit të ofertave në datën e zhvillimit të procedurës operatori ekonomik ndër të tjera ka dorëzuar një mostër të letrës A4 e cila plotëson vetëm 2 specifikime teknike nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor e dokumentet e tenderit, konkretisht plotëson vetëm gramaturën 80gr/m2 dhe numrin e fletëve (500fletë). Gjithashtu, nga verifikimi i bërë nga autoriteti kontraktor në disa faqe të internetit për këtë model letre të markës Happy Office nuk gjendet asnjë specifikim tjetër (Bardhësi:152-160% dhe pa llustër, Lëmueshmëria: 80-100ml/min, Lagështira:3.5-4.5%, Trashësia:104-112µm, Afësia në përkulje:>110mN DM, Ashpërsia në përkulje:>50nM CD, Drita:>=95%, Shkëlqimi:101-104%), në mënyrë që autoriteti kontraktor të bindet që kjo mostër e dorëzuar do të plotësojë të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Operatori ekonomik nuk kualifikohet në lidhje me këtë kriter. Ju drejtuam me ankesë në datën 14.05.2021, por akoma edhe sot nuk kemi një përgjigje.

Autoriteti kontraktor pretendon që letra e paraqitur mostër nga ana jonë plotëson vetëm dy specifikime teknike nga ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht plotëson vetëm gramaturën 80gr/m2 dhe numrin e fletëve (500fletë). Ne mendojmë se autoriteti kontraktor i

ka parë këto dy specifikime të shënuara në ambalazh, dhe pretendon që specifikimet e tjera nuk i plotëson sepse nuk i ka parë të shkruara në ambalazh. Asnjë lloj letre, e cilitdo prodhues, edhe ato të paraqitura mostra nga operatorët ekonomikë që janë kualifikuar të rregullt, nuk kanë të shënuar në ambalazh specifikimet si bardhësia, lëmueshmëria, lagështira, trashësia, aftësia në përkulje, ashpërsia në përkulje, drita, shkëlqimi. Asnjë prodhues letre nuk i shënon këto specifikime në ambalazhin e letrës. Për më tepër, as vetë autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar në dokumentet e tenderit që specifikimet e letrës të ishin të shënuara në ambalazh. Për verifikimin e specifikimeve autoriteti kontraktor duhet të kërkonte dokumentin përkatës ( skedën teknike), ose të na kërkonte sqarime për vlerësimin e ofertës bazuar në nenin 53, pika 1. Në rekomandimin e APP nr. 3341/I prot., datë 20.03.2018, pikërisht për këtë çështje, APP rekomandon se bazuar në nenet 26, 27, 28 të “Rregullave të prokurimit publik” autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkretë që duhet të parqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Më e rëndësishmja është se, me sa lexojmë në arsyen për skualifikim, autoriteti kontraktor nuk përcakton se cilin kriter të vendosur në dokumentat e tenderit nuk kemi përmbushur. Autoriteti kontraktor vetë konfirmon që e vetmja kërkesë ishte paraqitja e mostrave për letër A4 dhe A3 dhe në këtë kërkesë e kemi përmbushur. Pra, autoriteti kontraktor nuk ka gjetur dot një mosplotësim kriteri në ofertën tonë. Në dokumentet e tenderit në fjalë nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin ndonjë dokument në lidhje me specifikimet teknike të letrës. Autoriteti kontraktor ka bërë verifikime në internet dhe nuk ka arritur të gjejë specifikime për letrën e ofertuar nga ana jonë, por nuk mund të skualifikohemi ne si ofertues pse prodhuesi i letrës nuk ka publikuar online specifikimet teknike për këtë letër. Politikat e prodhuesve nuk janë në kompetencën tonë si tregtues të produktit, prodhuesit kanë planet e tyre të zhvillimit të biznesit dhe vendosin vetë se çfarë duan të publikojnë në internet dhe çfarë jo. Kjo është një vendimmarrje tërësisht jashtë vullnetit apo ndikimit tonë, dhe nuk mund të jetë kurrësi arsye për skualifikim. Fakti që specifikimet nuk janë publikuar online, nuk do të thotë që letra e paraqitur mostër nga ana jonë nuk i përmbush ato specifikime. Letra përmbush çdo specifikim të kërkuar, qofshin këto të publikuara online apo jo. Autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e mostrës dhe në plotësuam kriterin që autoriteti kontraktor kishte vendosur në dokumentat e tenderit. Nuk është kërkuar paraqitja e asnjë dokumenti tjetër, dhe as nuk është kërkuar që specifikimet të ishin të publikuara online, as për letrën, as për tonerat, as për ndonjë artikull tjetër. Pra, nuk jemi aspak në kushtet e mosplotësimin të ndonjë kriteri të vendosur në dokumentat e tenderit. Plotësuam me përpikmëri çdo kriter që autoriteti kontraktor kishte vendosur. Në këtë rast autoriteti kontraktor ka përdorur si kriter vlerësimi faktin nëse specifikimet janë publikuar online nga prodhuesi respektiv apo jo, gjë që nuk ishte përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke krijuar pabarazi në vlerësim dhe trajtim aspak të barabartë të operatorëve ekonomikë. Pra është e qartë se nga komisioni i vlerësimit të ofertave është përdorur një kriter i pa kërkuar, çka përbën shkelje të rregullave ligjore në lidhje me procesin e vlerësimit të prokurimit publik. Më tej, sqarojmë se komisioni i vlerësimit të ofertave e autoriteti kontraktor, nëse do të kishte pasur paqartësi në lidhje me përmbushjen e elementëve të veçantë teknike, duhej të kishte ndjekur procedurën e parashikuar nga neni 53, pika 1 e LPP. Nëse do të kishte ndjekur këtë procedurë, ne do të kishim vënë në dispozicion komisionit të vlerësimit të ofertave çdo sqarim të nevojshëm. Në të njëjtën situatë, kur një autoritet kontraktor kishte

*kërkuar që specifikimet e letrës të gjendeshin të publikuara online, KPP me vendimin nr. 781 Prot., datë 16.07.2020, hodhi poshtë këtë pretendim.*

*Autoriteti kontraktor nuk mund të na skualifikojë për një kriter që nuk e kishte vendosur në dokumentet e tenderit: publikimin online të specifikimeve teknike të letrës. Kemi plotësuar të gjitha ato kërkesa që autoriteti kontraktor ka të arsyeshme të vendosë për këtë procedurë. Letra e ofruar nga ana jonë mund të jetë shumë më cilësore se ajo e paraqitur nga operatorët ekonomikë të vlerësuar të rregullt, por skualifikohemi sepse prodhuesi nuk ka publikuar online specifikimet, gjë të cilën as e kishit kërkuar. Pasi u bëmë me dije për arsyen e skualifikimit, kërkuam nga furnitori “Algrafika” SHPK të na pajisë me dokument ku të jenë të pasqyruar të dhënat teknike të artikullit letër. Bashkëngjitur do të gjeni të dhënat e laboratorit fiziko-mekanik dhe kimik të tekstilit dhe lëkurës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, i akredituar nga Drejtoria e Akreditimit Tiranë. Ky laborator njihet nga Komisioni Prokurimit Publik, në vlerësimet e tij. Konkretisht, testimi i letrës në këtë laborator po përdoret nga KPP si pjesë e vlerësimit në një procedurë shqyrtim ankese, lidhur me tenderin me objekt: “Loti 1 Blerje letër A4” të zhvilluar nga Posta Shqiptare. Duket qartë, që letra plotëson të gjitha parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Oferta jonë është në përputhje me çdo kërkesë të tenderit. Autoriteti kontraktor në arsyen për skualifikim nuk na ka thënë se cilën kërkesë të shprehur në dokumentet e tenderit nuk kemi plotësuar. Kjo arsye skualifikimi është jo ligjore. Po paraqesim këtë ankesë, duke kërkuar nxjerrjen e një klasifikimi të ri, ku oferta jonë të kualifikohet e rregullt”.*

II.6. Referuar parashtrimeve në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik operatori ekonomik ankimues pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me datë 14.05.2021. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi rezulton se ky i fundit nuk ka bashkëlidhur formularin e ankesës depozituar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 07.06.2021 me anë të shkresës nr. 2451 prot., datë 03.06.2021, protokolluar me tonën me nr. 921/2 prot., datë 07.06.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, në faqen e parë të të cilit sqarohet se: “Shohim në faqen tuaj zyrtare që është depozituar një ankesë edhe nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK. Ju bëjmë me dije se, ky operator ekonomik nuk ka zbatuar hierarkinë për ankimimin e procedurës, referuar nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në institucionin tonë, Bashkia Elbasan, nuk është depozituar asnjë ankesë nga ky operator, gjatë afatit të ankesave për vlerësimin e procedurës”.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 05.02.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me nr. REF-86005-02-04-2021, me objekt: “*Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, QKB, Agjencinë e Pyjeve, SHMZSH dhe Gjendjen Civile*” - *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 8,421,400 (tetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e katërqind) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.

III.1.2. Në datën 19.04.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 07.05.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Infosoft Office	296,867.97	I skualifikuar
- Artan Llozana	327,126.21	I kualifikuar
- Ervin Luzi	403,965.00	I skualifikuar
- Interlogistic	635,846.82	I kualifikuar

III.1.4. Në datën 07.05.2021 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Referuar parashtrimeve në ankesën drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik operatori ekonomik ankimues pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor më datë 14.05.2021. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi rezulton se ky i fundit nuk ka bashkëlidhur formularin e ankesës depozituar pranë autoritetit kontraktor.

III.1.6. Në datën 07.06.2021 me anë të shkresës nr. 2451 prot., datë 03.06.2021, protokolluar me tonën me nr. 921/2 prot., datë 07.06.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, në faqen e parë të të cilit sqarohet se: “*Shohim në faqen tuaj zyrtare që është depozituar një ankesë edhe nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK. Ju bëjmë me dije se, ky operator ekonomik nuk ka zbatuar hierarkinë për ankimin e procedurës, referuar nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në institucionin tonë, Bashkia Elbasan, nuk është depozituar asnjë ankesë nga ky operator, gjatë afatit të ankesave për vlerësimin e procedurës*”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK lidhur me skualifikimin e ofertës së tij referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP-së, nuk janë ngritur pranë autoritetit kontraktor por vetëm pranë KPP-së duke mos respektuar kështu shkallët e ankimit të përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku përcaktohet qartësisht se: “1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. **Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.**

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor. 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, **shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor**”. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative

*dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme”.*

III.1.8. Sa më sipër KPP gjykon se, operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte ngritur pretendimet lidhur me skualifikimin e ofertës së tij së pari pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik e më pas edhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankesë pranë autoritetit kontraktor. Rezultoi e provuar se, nga ana e ankimuesit është paraqitur vetëm një formular ankesë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo autoritetit kontraktor. Konkretisht, referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se, ky operator ekonomik ankimues nuk ka zbatuar hierarkinë për ankimin e procedurës, referuar nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi në autoritetin kontraktor, Bashkia Elbasan, nuk është depozituar asnjë ankesë nga ky ankimues, gjatë afatit të ankesave për vlerësimin e procedurës.

III.1.9. Referuar parashtrimeve me shkrim paraqitur në ankesën depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pala ankimuese pretendon *inter alia* se “Në datën 14.05.2021, ankimuesi “Infosoft Office” SHPK i është drejtuar AK me anë të një ankesë për arsyet e skualifikimit të ofertës së tij, por që edhe sot nuk ka marrë përgjigje”. KPP gjykon se, në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik *onus probandi incumbit actor* (barra e provës i bie kërkuesit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “..në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Operatori ekonomik ankimues në asnjë rast nuk ka sqaruar, argumentuar dhe më pas provuar me dokumente shtesë faktin se ankimi i paraqitur nga ky i fundit është dorëzuar brenda afatit kohor (datë 14.05.2021) pranë autoritetit kontraktor.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.



III.1.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në këto kushte sa më sipër analizuar, pretendimet e mësipërme të ngritura nga operatori ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim për shkak të mosndjekjes së shkallëve të ankimimit në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në respekt të legjislacionit për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me nr. REF-86005-02-04-2021, me objekt “Blerje kancelari dhe bojëra për Bashkinë, QKB, Agjencinë e Pyjeve, SHMZSH dhe Gjendjen Civile” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 8,421,400 (tetë milion e katërqind e njëzet e një mijë e katërqind) lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 19.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 921 Protokoli, Datë 28.05.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**